



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 mars 2016
Nr. ref.:RK905/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI54/15

Parashtrues

Melihate Nura

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
ARJ. nr. 31/2014, të 14 janarit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare, dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Melihate Nura nga Prishtina, të cilën në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson e bija e saj znj. Afërdita Nura-Lama (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [ARJ. nr. 31/2014], i 14 janarit 2015. Ky Aktgjykim i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 13 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur neni 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 prill 2015, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 2 qershor 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI54/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI54/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 1 korrik 2015, me Vendimin GJR. KI54/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit më 26 qershor 2015, i skadoi mandati në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 20 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 28 janar 2016, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 7 nëntor 2007, Komuna e Prishtinës nxori Aktvendimin [05 nr. 350-23648] me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtrueses për dhënien e lejes tekniko-urbanistike për renovimin e objektit të banimit të dëmtuar.
11. Kundër Aktvendimit të lartcekur, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në organin e shkallës së dytë të Komunës së Prishtinës.

12. Më 22 shkurt 2008, organi i shkallës së dytë të Komunës së Prishtinës nxori Vendimin [01 nr. 350-23648], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar.
13. Kundër vendimeve të lartcekura të Komunës së Prishtinës, parashtruesja parashtrroi ankesë në Kolegjin për çështje administrative të Gjykatës Supreme të Kosovës, si gjykatë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla sipas Ligjit për gjykatat i zbatueshëm në atë kohë.
14. Më 31 tetor 2012, Kolegji për çështje administrative i Gjykatës Supreme të Kosovës [Aktgjykimi A. nr. 607/2008] e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar.
15. Kundër Aktgjykimit të shkallës së parë [A. nr. 607/2008] të Gjykatës Supreme, parashtruesja parashtrroi ankesë në Kolegjin e shkallës së dytë për çështje administrative të Gjykatës Supreme, si gjykatë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla sipas Ligjit për gjykatat të zbatueshëm në atë kohë.
16. Duke pasur parasysh hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për gjykatat, sipas ankesës së parashtrueses vendosi Departamenti për çështje administrative të Gjykatës së Apelit. Në lidhje me juridiksionin e gjykatës në këtë rast Gjykata e Apelit konstatoi në vijim:

“Gjykata e Apelit ka juridiksion në këtë çështje juridike në bazë të nenit 39 të Ligjit për gjykatat nr. 03/L-199, me të cilin është përcaktuar se: "të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës së lartë për kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë me 1 janar të vitit 2013, trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit”.

17. Më 24 korrik 2014, Departamenti për çështje administrative i Gjykatës së Apelit e hodhi poshtë [Aktgjykimi AA. nr. 59/2014] ankesën e parashtrueses si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin [A. nr. 607/2008] të Gjykatës Supreme.
18. Më 14 tetor 2014, parashtruesja dorëzoi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.
19. Më 14 janar 2015, Gjykata Supreme [Aktvendimi ARJ. nr. 31/2014] e refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [AA. nr. 59/2014] dhe Aktgjykimit [A. nr. 607/2008] të Gjykatës Supreme, si të pavlefshme, pasi është paraqitur jashtë afatit të paraparë me ligj.

Dispozita relevante ligjore lidhur me Ligjin për gjykatat

LIGJI PËR GJYKATAT NR. 03 L-199

Neni 39

Zgjidhja e lëndëve të pakryera

1. Të gjitha lëndët, të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit.

2. Të gjitha lëndët, të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së parë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut, Gjykatës Ekonomike të Qarkut, Gjykatës Komunale apo Gjykatave Komunale për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës Themelore e cila ka juridiksionin territorial përkatës.

Ligji hyri në fuqi më 1 janar 2011.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës pretendon:

“Gjykata më e ulët, në këtë rast Gjykata e Apelit, kurrsesi nuk mundet të vendosë sipas ankesës së ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, pra të Gjykatës më të Lartë”.

21. Parashtruesja e kërkesës, më tej, pretendon:

“Në rastin konkret kompetente për të vendosur përkitazi me ankesën e ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 607/2008, dt. 31.10.2012, është vetëm Gjykata Supreme e Kosovës”.

22. Parashtruesja kërkon nga Gjykata:

“Për këtë çështje në shkallë të dytë të vendosë Gjykata Supreme e Kosovës, si Gjykatë kompetente në këtë rast, ose në rastin më të mirë nëse anulohen të dy aktgjykimet e përmendura, pra i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës, atëherë Gjykata kompetente të vendosë sipas ligjit”.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara më Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

27. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ankohet në faktin se për ankesën kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ka vendosur Gjykata e Apelit, dhe si rrjedhojë i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor].

28. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit shpjegoi në detaje çështjen e kompetencës në këtë rast, duke cituar Ligjin për gjykatat, Nr. 03/L-199, në bazë të cilit Gjykata e Apelit kishte juridiksion për të vendosur për rastin konkret juridik, prandaj, Gjykata e Apelit i arsyetoi vendimet e saj dhe argumentoi çdo pretendim të parashtrueses në lidhje me refuzimin e ankesës së saj.

29. Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtrueses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit si të palejuar, sepse është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor.

30. Gjykata rithekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e marra nga Gjykata Supreme. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të përcakton nëse procedurat e gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë dëshmitë (Shih, Rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, më 10 korrik 1991).

31. Në këtë rast, Gjykata nuk konstaton se procedurat përkatëse para Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

32. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesja nuk e ka mbështetur pretendimin e saj në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë provë për të treguar se si dhe pse të drejtat dhe liritë e saj të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur me vendimin e kontestuar.

33. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 janar 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi